



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë/MinistarsvoPravde/Ministry of Justice

Divizioni për Burime Njerëzore-Odsek za Ljudske Resurse-Division of Human Resources

Data: 04.07.2025

Duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr.731/2025 dhe Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë njofton si në vijim:

NJOFTIM

Anulohet procedura e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00016187, për Grupin e Arkiv-dokumentacionit, pozita e punës “Zyrtar për Arkiv” publikuar me datën 25.02.2025 në afatin për aplikim 26.02.2025 deri më 27.03.2025 me Nr. RN00016187 për arsye se me datën 20.06.2025 është pranuar vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me të cilin ka anuluar në tërësi konkursin dhe ka obliguar për zbatimin e këtij vendimi Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë.

Këshilla Juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Arta Nuredini Durmishi

Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore



Pranimi / Dorezimi Punimori / Predato Received / Delivery	18.06.2025	viti year	2025
Organ / Rrethi Organ / Jednoca Org / Unit	Prishtine	Numeri Proc. g. Z-prenosi	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.731/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.731/2025, të datës 25.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, Magbule Dinarica Kuçi, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.06.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.731/2025, e datës 25.04.2025, e parashtruar nga ankuesja, Magbule Dinarica - Kuçi.

II. Anulohet në tërësi procedura e pranimit sipas Konkursi me numër reference RN00016817, për Grupin e Arkiv-dokumentacionit, pozita e punës “Zyrtar për Arkiv”, e shpallur me datë 25.02.2025, nga Ministria e Drejtësisë

III. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ashtu, sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, Magbule Dinarica Kuçi (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 25.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2746/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.731/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference **RN00016817**, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 25.02.2025, nga Ministria e Drejtësisë, Grupi i arkiv –dokumentacionit për pozitën e punës “Zyrtar për arkiv”, klasa e pozitës Profesional 3.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullos Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave,

me datë 06.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit, më datë 10.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me nr prot 2746/2025 të datës 25.04.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit të ankueses: Konkursi; Njoftimin e datës 07.04.2025; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 18.04.2025; Njoftimin e datës 17.04.2025; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës me nr prot 731/2025 I datës 10.06.2025; Listën e aplikantëve; Listën e kandidatëve të refuzuar; Aplikacionin e M.K të datës 26.02.2025; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 18.04.2025; Aplikacionin e R.I të datës 26.02.2025; Vendimin e datës 02.04.2025; Akt emërimi i datës 22.05.2023; Akt emërimi i datës 02.09.2024; Akt emërimi i datës 17.12.2024; Akt emërimi i datës 02.09.2024; Akt emërimi i datës 23.12.2024; Njoftimin për mbajtjen e testit me shkrim; E-mailat e datës 02.04.2025; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së të kandidatëve nga Komisioni I pranimit; E-mailat e shkëmbyera të datës 15.04.2025; E-mail i datës 11.04.2025; Njoftimi për mbajtjen e testit me shkrim; Njoftimi i datës 17.04.2025; E-mail i datës 17.04.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 18.04.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtareve të Komisionit për kandidatët në intervistë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrejdhe se Ministria e Drejtësisë më datë 25.02.2025, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00016817, për Grupi i Arkiv-dokumentacionit, respektivisht për pozitën e punës "Zyrtar për Arkiv", klasa profesional 3, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.02.2025 deri më datën 27.03.2025. Rrjedhimisht, në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë gjashtëdhjetëetë (68) kandidatë, përfshirë ankuesen, ndërsa, vetëm tridhjetë (30) kandidatë, duke përfshirë këtu edhe ankuesen, kanë hyrë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale për pozitën e shpallur.

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja i është nënshtruar fazës së vlerësimit përmes testimit me shkrim dhe vlerësimit të intervistës me gojë, ku nga këto vlerësime gjegjësisht në testin me shkrim ka marrë gjithsej 40.2 pikë, dhe nuk ka mundur të marrë pjesë në procedurat tjera të konkursit, gjegjësisht në, në intervistën me gojë.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, me datë 18.04.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja Rina Imeri është shpallur kandidate fitues për pozitën përkatëse të punës, përkatësisht Zyrtar i Arkiv, me gjithsejtë 83.2 pikë.

E pakënaqur me rezultatin përfundimtar të vlerësimit, ankuesja, me datë 25.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën përkatëse të punës është zhvilluar përmes shkeljes së ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, sepse, ankuesja pretendon se ka pasur manipulime me rastin e përzgjedhjes së kandidatit fitues.

Kolegji i Këshillit në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër reference RN00016817, për Grupin e arkiv-dokumentacionit, gjegjësisht pozitën "Zyrtar për Arkiv", Profesional 3, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se, organi përkatës i punësimit, si kritere të përgjithshme formale, në



konkursin përkatës të punës ka vendosur: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor): Fusha: Juridik/Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë/antropologji/Ballkanistikë. Kërkesat specifike: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vite përvojë pune profesionale.**

Referuar dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojca Nr.1/7: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 3, si kërkesa të përgjithshme formale për klasën profesional 3 kërkohen: a) **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të. b) Kërkesat specifike: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi. c) Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.** Kështu që nisur nga ky përcaktim ligjor, rezultoi se organi përkatës i punësimit gjegjësisht Ministria e Drejtësisë, me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën "Zyrtar për Arkiv", klasa profesional 3, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe me Katalogun e vendeve të punës për shërbimin civil i miratuar me vendimin Nr.08/226 të datës 23.10.2024 e qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse sipas bazës ligjore si me lartë, për pozitën e kategorisë profesional 3, kërkohet vetëm shkollim i mesëm, pa përvojë pune, ndërsa në rastin konkret është vendosur si kriter i përgjithshëm diploma e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) dhe përvojë një(1) vjetare profesionale.

Si rrjedhojë, nisur nga konstatimi se vendosja e kriterëve të konkursit është në kundërshtim me kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, atëherë në gjykimin e Kolegjit rrjedhë se procedura e pranimit sipas Konkursit publik me numër reference RN00016817, për Grupin e Arkiv-dokumentacionit, respektivisht për pozitën e punës "Zyrtar për Arkiv", klasa profesional 3, e shpallur nga Ministria e Drejtësisë, është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar se: "1. Pranimi në detyrë i nëpunës/it civil, nëpunës/it të shërbimit publik, krijues/it dhe performues/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunës/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese". Andaj, për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Siç u konstatu me sipër, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Numri i lëndës: A.nr.731/2025
Datë: 17.06.2025
Numri i protokollit: xxxx/2025

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr. 731/2025

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Magbule Dinarica Kuçi;
- Njësisë se Personelit në Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.